INDIFFERENCE KILLS THE NATION – (INDIFERENCA E VRET KOMBIN)

Përgatitur nga Mal Berisha

CURIOSITY KILLS THE CAT - KURESHTJA E MBYT EDHE MACEN!

(Proverb anglez)

Hyrje: Si një njeri kurioz, mundohem të vë re gjithçka që lidhet me ruajtjen, krijimin dhe ekspozimin e vlerave tona kombëtare. Rasti që po paraqes më poshtë është produkt i kësaj prirjeje. — Kureshtja e mbyt edhe njeriun!

INDIFFERENCE KILLS THE NATION – INDIFERENCA E VRET KOMBIN

(proverb shqiptar!?)

Ajo që do t'ju tregoj më poshtë, e vërteton më së miri thënien e mësipërme:

Në hyrje të Tiranës, aty ku dikur ngrihej një skulpturë monumentale e shqiponjës dykrenare, (shiko foton n fund te tekstit) simboli më i fuqishëm i identitetit tonë kombëtar, në anën e djathtë të autobandit, sot të shfaqet një pikturë murale që reklamon birrën "Peja", e titulluar:

"VAJZA ME PEJA".

Së pari, ky emërtim përbën një dhunim të gjuhës shqipe. Asnjë studiues serioz nuk do ta konsideronte të drejtë

gramatikisht një emërtim të tillë: “VAJZA ME PEJA”, i cili është plotësisht i papranueshëm në normat e shqipes letrare.

Zëvendësimi i shqiponjës me këtë pikturë nuk është thjesht një ndryshim estetik, por një tregues i një krize më të thellë kulturore dhe shpirtërore që ka kapluar shoqërinë shqiptare.

Monumenti i Shqiponjës, i vendosur në vitin 2012 për nder të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, ishte një simbol bashkimi, vetëdijeje dhe përkatësie kombëtare. Zhdukja dhe shkatërrimi i saj gjatë punimeve për Unazën e Madhe përbën një akt të pastër mosrespektimi ndaj historisë sonë dhe nevojës për kohezion gjithëkombëtar.

Në vend të saj, sot, në hyrje të Tiranës ndodhet një mural i vizatuar nga një artist amator argjentinas, Maximiliano Bagnasco, i cili bën një plagjiaturë të imazhit të pikturës “Vajza me vathë perle” të piktorit holandez Johannes Vermeer, e realizuar rreth vitit 1665, me logon e një birre. Kjo figurë nuk ka asnjë lidhje me historinë apo identitetin shqiptar, dhe nuk përçon as krenari kombëtare, as frymëzim, por thjesht një mesazh konsumizmi alkoolik dhe banaliteti estetik. Dhe ku? Bash në ballin e pamjes së kryeqytetit!

Ky nuk është vetëm një rast i zëvendësimit të një vepre arti. Është një shenjë alarmi për fshirjen e kujtesës kolektive dhe zëvendësimin e idealeve me reklama të zbrazëta.

Anglezët thonë: Kureshtja e vret edhe macen! Ndërsa ne, jo vetëm që nuk na bën përshtypje, por me indiferencën tonë e pranojmë një akt të tillë pa asnjë kundërshtim. Janë katër murale të tilla të këtij artisti argjentinas në Tiranë për Lionel Messin dhe Maradonën, por nëse do të dëshironim vërtet të llangosnim muret e pallateve tona, le të ishte Panajot Pano, Medin Zhega, Genc Tomorri që i bëri gol gjermanëve në fushën e vet...!?

Kjo është keqbërja më e vogël në këtë vend. Si çdo gjë tjetër, edhe kjo është një nga ato që, me indiferencën tonë, e legjitimojmë.

INDIFFERENCE KILLS THE NATION – INDIFERENCA E VRET KOMBIN (proverb shqiptar!?)

Sa ëashtë paguar ky piktor surrogatosh nga taksat tona të dashur qyttarë të kryeqytetit?


Vajza me Peja
CITY SCREENS

AFA